



Provincia di Pisa



# Udhëzues në kërkimin të punës për qytetarët imigrantë

Nën përkujdesjen e  
**Elisa Bulleri e Romina Pelosini**



PACINEditore

© Copyright 2006 Istituzione centro Nord-Sud - Provincia di Pisa

*Realizimi për botim*



**PACIN**Editore

Pacini Editore SpA, Ospedaletto, Pisa

*Fotoliti dhe shtypi*

IGP - Industrie Grafiche Pacini, Ospedaletto, Pisa

## Pasqyra e lëndës

Prezantimi .....	5
<b>I. Kushtet për punësim .....</b>	<b>7</b>
<b>II. Modifikime të futura nëpërmjet D.lgs 276/03</b>	
(Ligji Biagji - Legge Biagi) .....	9
<b>1. Puna si Vartës.....</b>	<b>9</b>
1.1 <i>Informacione të mëtejshme.....</i>	12
1.2 <i>Puna në bujqësi .....</i>	13
<b>2. Punësimi sezonal .....</b>	<b>15</b>
<b>3. Puna e pavarur .....</b>	<b>16</b>
3.1 <i>Tregtim ambulant.....</i>	18
3.2 <i>Ndërmarrja .....</i>	22
3.2.1 <i>Ndërmarrja individuale .....</i>	22
3.2.2 <i>ImNdërmarrja kolektive (S.r.l., S.n.c., S.a.s.) .....</i>	24
3.3 <i>Kooperativa .....</i>	25
<b>4. Puna shtëpiake.....</b>	<b>27</b>

<b>5. Informacione të nevojshme .....</b>	<b>29</b>
5.1 Sporteli Unik për Imigrimin (SUI) (Sportello Unico per l'Immigrazione).....	29
5.2 Kontrata e qëndrimit (Contratto di soggiorno)	30
5.3 Lejeqëndrimi (Permesso di soggiorno).....	32
5.4 Kodi Fiskal .....	34
5.5 Regjistrimi në listën e arkivit të punonjësve të disponueshëm .....	35
5.6 Mbrojtja e amësisë dhe e atësisë në vendin e punës .....	36
5.7 Aksidentet në punë.....	37
 <i>Dekreti i kuotave të punësimit .....</i>	 38
 <b>6. Sporteli unik për imigrimin     qendrat e asistencës pa pagesë .....</b>	 39
 <b>7. Adresa të nevojshme .....</b>	 45

## Prezantimi

Me këtë Udhëzues kemi qëllim të ofrojmë një instrument praktik dhe lehtësisht të lexueshëm në lidhje me temën e punësimit për të gjithë imigrantët që gjenden në territorin e provincës.

Konteksti në të cilin hyn kjo broshurë ndjek udhëzimin që është dhënë në Këshillin Provincial (Consiglio Provinciale) të datës 17 qershor të vitit 2000 me të cilin Institucioni Qendër Veri-Jug, (Insituzione Centro Nord-Sud), si organizëm instrumental i Provincës së Pizës për zbatimin e politikave të imigrimit, është thirrur për të nxitur krijimin dhe azhurnimin e vazhdueshëm të udhëzuesve e të broshurave për orientim, të përkthyer në gjuhë të ndryshme dhe bazohet në vetëdijen se politikat e pritjes dhe të integritit janë të lidhura ngushtë dhe në mënyrë të pashmangshme me problemin e shfrytëzimit të shërbimeve të ndryshme nga imigrantët.

Iniciativa është vazhdimësi e një rruge të ndjekur nga Institucioni, që nga viti 2003, nëpërmjet Tavolinës së Koordinimit të Imigracionit dhe, veçanërisht nëpërmjet Grupit Punë e Formim profesional në të cilin është realizuar një bashkëveprim i vlefshëm programatik dhe operativ me Shërbimet e Politikës aktive të punësimit, duke parashikuar se hyrja në tregun e punës është një pikë kyçe e nevojshme në rrugën për integrimin social.

Udhëzuesi përmban këshilla të nevojshme për procedu-

rat administrative dhe normativat që rregullojnë aktivitetet e ndryshme të punës (punë e pavarur, punë si vartës, punë sezonale, punë shtëpiake) dhe disa informacione themelore në lidhje me aspektet kryesore që karakterizojnë ambientin e punës (lejeqëndrimi, kontrata e punësim/qëndrimit, kodi fiskal, regjistrimi në listën e arkivit për punonjësit e disponueshëm, mbrojtja e mëmësisë dhe e atësisë në vendin e punës, aksidentet në punë).

Përveç të tjerash udhëzuesi përmban një listë adresash për disa shërbime të nevojshme (Qendrat e asistencës pa pagesë (Centri di assistenza gratuiti) të lidhura me SUI dhe Qendrat për Punësim (Centri per l'Impiego), Zyra e Taksave (Agenzia delle Entrate), Zyra e Regjistrimit të Ndërmarrjeve (Ufficio Registro delle Imprese), Kuestura - Zyra e imigrimit (Ufficio immigrazione), Prefektura – Zyra e imigrimit (Ufficio immigrazione), I.N .P.S, I.N .A.I.L., Confartigianato) tek të cilat qytetarët e huaj mund të drejtohen.

*Presidentja*  
*Institucioni Qendër Veri - Jug*  
*Këshilltare për Politikë Sociale,*  
*Imigrimi Mundësi të Barabarta,*  
*Sektori i Tretë*  
**Dott.ssa Manola Guazzini**

*Këshilltare për Politikë e Punës*  
*dhe Formimin Profesional*  
**Anna Romei**

### **Falënderojmë për bashkëpunimin:**

Confesercenti Pisa, Ascom Pisa dhe Qendrat për Punësim (Centri per l'Impiego) të Provincës së Pizës dhe veçanërisht Pieranna Casali e Maria Luisa Mazzanti (Centro per l'Impiego di S. Croce sull'Arno).

## I. Kushtet për punësim

Hyrja në Itali e punonjësve që nuk bëjnë pjesë në komunitetin evropian, për punë si vartës, të pavarur ose për punë sezonale, rregullohet sipas-kuotave të vendosura nga Ligji 189/2002 (neni. 3 paragrafi 2) të cilat përcaktohen çdo vit brenda 30 nëntorit mbi bazën e vendimeve të marra nga Dokumenti Programatik (Documento Programmatico), që hartohet çdo tre vjet nga Presidenti i Këshillit të Ministrave dhe me tej i aprovuar nga Qeveria. Në rast nevojë, gjatë vitit mund të nxirren dekrete të tjerë.

### DUHET MBAJTUR MEND

Për të hyrë dhe për të punuar në Itali është e nevojshme të marrja e një lejeqëndrimi i cili mund të lëshohet për arsye të ndryshme:

- punë si vartës
- punë e autonome (e pavarur)
- punë si vartës-stinore (sezonale)
- bashkim familjar ose për arsye familje
- studim ose formim (specializim)
- azil politik
- në pritje të punësimit
- arsye për mbrojtje sociale

## II. Modifikime të aplikuara nëpërmjet dekretit

### D.lgs 276/03

(Legge Biagi)

Dekreti legjislativ 276/03 ka futur tipologji të reja kontratash që do të aplikohen në tregun e punës italian. Një qytetar që nuk bën pjesë në komunitetin evropian (jokomunitar) i cili qëndron rregullisht në territorin kombëtar, mund të nënshkruajë çdo tip kontrate punësimi që parashikohet nga ligji italian. Qytetarit që nuk bën pjesë në komunitetin evropian (jokomunitar) e që qëndron rregullisht i njihet e drejta themelore e **barazisë në trajtim dhe e mundësive të barabarta**.

### 1. Puna si vartës

1. Punëdhënësi italian ose i huaj që qëndron rregullisht në Itali që dëshiron të krijojë një raport pune vartësie me një qytetar të huaj që është rezident jashtë shtetit duhet të paraqesë tek Sporteli Unik për imigrimin (Sportello Unico per l'Immigrazione), që gjendet pranë selisë së Prefekturës së provincës së rezidencës, ose asaj ku ka selinë ndërmarrja apo të asaj ku do të zhvillohet aktiviteti i punës, kërkesën me emër për lejen (nullaosta) për punë; kjo kërkesë duhet të përmbajë:

- ◆ dokumentacionin e përshtatshëm në lidhje me sistemin banues për punonjësin e huaj;
- ◆ propozimin për kontratë e punësim/qëndrimin duke përcaktuar kushtet përkatëse ndër të cilave zotimin nga ana e punëdhënësit për të paguar kthimin e të huajit në Vendlindje
- ◆ deklaratën e zotimit për të komunikuar çdo ndryshim që ka të bëjë me raportin e punësimit

2. Sporteli Unik për Imigrimin (*Sportello Unico per l'Immigrazione*)<sup>1</sup>, brenda 40 ditëve nga paraqitja e kërkesës, lëshon një autorizim të përkohshëm të nevojshëm për vizën e hyrjes. Më tej, me kërkesën e punëdhënësit, dërgon dokumentacionin (përfshirë dhe kodin fiskal (*codice fiscale*))<sup>2</sup> zyrave konsullore italiane të Vendit ku ka rezidencën punonjësi i huaj. Zyrat konsullore japin vizën e hyrjes duke shënuar kodin fiskal.

3. Brenda 8 ditësh nga hyrja në Itali i huaji duhet të paraqitet për të firmosur **kontratën e qëndrimit** (*contratto di soggiorno*) pranë Sportelit Unik për Imigrimin që ka lëshuar autorizimin (nulla osta). Sporteli Unik ia transmeton kopjen e kontratës së qëndrimit autoriteteve konsullore kompetente dhe qendrës kompetente për punësim.

---

<sup>1</sup> Për sqarime të mëtejshme shih edhe paragrafin 5.1

<sup>2</sup> Për sqarime të mëtejshme shih edhe paragrafin 5.4

## **E RËNDËSISHME!**

**Lejeqëndrimi për punë si vartës** lëshohet nga Sporteli Unik (Sportello Unico) pas nënshkrimit të kontratës së qëndrimit për punë. Kohëzgjatja e lejeqëndrimit përkatës është ajo që është parashikuar nga kontrata e qëndrimit, dhe nuk mund të tejkalojë dy vite.

**Vini Re: lejeqëndrimi për punë si vartës -nuk anulohet si rrjedhim i humbjes së vendit të punës.** Në fakt punonjësi i huaj që humbet vendin e punës mund të shënohet në listën e arkivit të Qendrës përkatëse për Punësim në bazë të vendbanimit deri në mbarimin e afatit të lejeqëndrimit dhe për një periudhë jo më të ulët se 6 muaj

### **Kontrata e punësim/qëndrimit (neni 6 paragrafi 1 L. 189/02)**

Punonjësi i huaj për të marrë një lejeqëndrim për punë si vartës duhet të ketë kontratën e punësim/qëndrimit. Kontrata duhet të përmbajë:

- garancinë nga ana e punëdhënësit të disponueshmërisë për një banesë për punonjësin e cila duhet të hyjë në parametrat minimal të parashikuar nga ligji për banesat e ndërtuara për rezidenca publike
- zotimin nga ana e punëdhënësit për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për kthimin e punonjësit në vendlindje.

(shih edhe paragrafin 5.2)

## *1.1. Informacione të mëtejshme*

1. Mund të kryejnë punë si vartës të huajt që janë në zotërim të:
  - ◆ kartës së përhershme të qëndrimit (carta di soggiorno)
  - ◆ lejeqëndrimt (permesso di soggiorno) për punë si vartës, të pavarur, për arsye familjare dhe për arsye të mbrojtjes sociale
  - ◆ lejeqëndrim për të mitur nën kujdestari, me kusht që i huaji të ketë mbushur moshën 15 vjeç dhe të ketë kryer shkollën e detyrueshme sipas normativës italiane
  - ◆ lejeqëndrim për strehim (azil) politik (duhet dokumenti që njih kushtin e refugjatit politik)
  - ◆ lejeqëndrim për studim ose formim: për periudhën e studimeve dhe për një kohë jo më shumë se 20 orë në javë dhe maksimumi 1040 orë në vit.
2. Në qoftë se punëdhënësi nuk e njeh personalisht të huajin mund të bëjë një kërkesë sipas numrit në drejtim të një ose më shumë të huajve të regjistruar në listat e parashikuara nga neni 21 paragrafi 5 i D.Lgs 286/98, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.

**Vini Re: qytetarët e huaj që janë të interesuar mund të kërkojnë regjistrimin në këto lista duke plotësuar formularin përkatës të përgatitur nga Ministria e Punës dhe e Sigurimeve Shoqërore (Ministero del Lavoro e della Previdenza sociale).**

3. Për të kryer një punë si vartës duhet kryer regjistrimi në listën e arkivit të punonjësve pranë Qendrës përkatëse për punësim në bazë të vendbanimit . Në momentin e regjistrimit punonjësi duhet të deklarojë gjendjen e tij si i papunë dhe veçanërisht:

- ◆ të mos kryej asnjë punë;
- ◆ të jetë menjëherë i disponueshëm, një propozimi për punësim;
- ◆ të kryejë kërkime aktive në lidhje me punën.



**KUJDES:** mungesa në takimin e orientimit të prenotuar me Qendrën për punësim dhe refuzimi pa arsye i një oferte pune sipas disponueshmërisë së deklaruar sjell si rezultat humbjen e gjendjes së papunësisë, eliminimin nga listat e arkivit dhe pamundësinë për të përfutur për 12 muaj nga shërbimet e Qendrës për punësim.

## *1.2 Puna në bujqësi (agrikulturë)*

Disiplina që rregullon raportin e punësimit në sektorin e bujqësisë mund të ketë të bëjë edhe me punonjësit jokomunitarë të cilët qëndrojnë rregullisht në Itali.

Konsiderohet punonjës në bujqësi (agrikulturë) personi që zhvillon aktivitetin e tij në varësi të një punëdhënësi në bujqësi (sipërmarrësi në bujqësi është ai që ushtron një nga këto aktivitete: kultivim tokash, pylltari, rritje kafshësh dhe

aktivitete të tjera të ngjashme).

Raporti i punës në bujqësi zgjat normalisht për një kohë të caktuar mbi bazën e cikleve stinore të kultivimeve. Në sektorin e bujqësisë lejohet mundësia e punësimit me kontratë pune part-time.

Hipotezat e ndërprerjes së raportit të punës janë të njëjta me ato që parashikohen për punonjësit vartës në përgjithësi.

Ekzistojnë tre tip kontratash për punën në bujqësi:

- ◆ Per Për kryerjen e punëve për një kohë të shkurtër, sezonale ose me karakter të përkohshëm, për fazën e punimeve ose për zëvendësimin e punonjësve që mungojnë për të cilët ekziston e drejta e ruajtjes së vendit të punës;
- ◆ Për kryerjen e disa punëve sezonale dhe/ose për disa faza punimesh në vit duke garantuar një punësim minimal më të madhe se 100 ditë pune në vit, gjatë 12 muajve, duke filluar nga data e marrjes në punë;
- ◆ Për një punë që zgjat më shumë se 180 ditë pune efektive, e kryer gjatë një raporti punësimi të vetëm të vazhdueshëm.



**KUJDES:** Punës si vartës në bujqësi i aplikohet i njëjti klasifikim që parashikohet për shumicën e punonjësve vartës edhe pse ky tip raport punësimi i nënshtrohet rregullave të veçanta, kryesisht për sa i përket fushës së sigurimeve shoqërore.

## 2. Puna stinore (sezonale)

Autorizimi për punë stinore lëshohet nga Sporteli Unik për Imigrimin (SUI) (Sportello Unico per l'Immigrazione) i provincës së rezidencës të punëdhënësit në rast se ekzistojnë kuotat e hyrjes për punë stinore. Ky autorizim lëshohet si rrjedhim i paraqitjes së kërkesës me emër për punësim nga ana e:

- ◆ punëdhënësit për punë stinore ose të huajit që qëndron rregullisht në Itali
- ◆ të shoqatave të kësaj kategorie për llogari të anëtarëve të tyre. Lejeqëndrimi për punë stinore ka një vlerë minimumi prej 20 ditësh deri 6 ose 9 muaj maksimum mbi bazën e kohëzgjatjes së punës në sektorët që kanë nevojë për një kohëzgjatje të tillë.



### **E RËNDËSISHME!**

Punonjësi sezonal që është kthyer në vendin e tij, pas mbarimit të afatit të lejeqëndrimit, ka të drejtën e përparësisë, për të hyrë në Itali për motive pune stinore në vitin pasardhës, ndaj shtetasete të Vendit të tij që nuk kanë hyrë asnjëherë në Itali rregullisht për të njëjtat arsye.

Punonjësit sezonal (stinorë) gëzojnë format e sigurimeve shoqërore dhe të asistencës së detyrueshme të mëposhtme, sipas normave në fuqi në sektorët e aktiviteteve që kryejnë:

- ◆ sigurim për pleqëri dhe paaftësi;
- ◆ sigurim për aksidente në punë dhe sëmundje të shkaktuar nga zhvillimi i aktivitetit punonjës;
- ◆ sigurim kundra sëmundjeve;
- ◆ sigurim i amësisë.

### 3. Puna e pavarur

Qytetari i huaj mund të zhvillojë në Itali aktivitet pune të pavarur, mund të krijojë shoqëri kapitalesh ose personash, të ketë përgjegjësi në shoqëri të ndryshme dhe të krijojë kooperativa me kusht që ushtrimi i këtyre aktiviteteve të mos jetë i rezervuar, nga ligji, për qytetarët italian ose për qytetarët e njërit nga Shtetet anëtarë të Bashkimit Evropian. Pra është e nevojshme zotërimi i një lejeqëndrimi të vlefshëm për punë të pavarur.

Për të marrë një lejeqëndrim për punë të pavarur qytetari i huaj duhet të kërkojë më parë vizën për punë të pavarur e cila parashikon lejen provizore nga Kuestura (Questura) e provincës në të cilën dëshiron të ushtrojë aktivitetin e tij. Pra duhet të tregojë:

- ◆ se ka burime të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit;
- ◆ se plotëson kushtet e parashikuara nga ligji italian për ushtrimin e aktivitetit përfshirë, dhe rastin kur kërkoht, dhe plotësimi i kushteve për regjistrim në listat dhe regjistrat e profesionistëve;

- ◆ se ka një vërtetim të autoriteteve kompetente i cili deklaron se nuk ka motive që pengojnë lëshimin e autorizimit ose të liçencës që parashikohet për ushtrimin e aktivitetit që i huaji ka ndërmend të zhvillojë (data e dokumentit nuk duhet të jetë më përpara se tre muaj);
- ◆ se ka një sistemim të përshtatshëm banimi;
- ◆ se ka të ardhura vjetore më të mëdha se niveli minimal që parashikohet nga ligji për përjashtimin nga shpenzimet sanitare.

Në qoftë se aktiviteti i pavarur zhvillohet pa karakteristikat e sipërmarrjes ose për të cilën nuk është i nevojshëm regjistrimi në një listë profesionale, shtetasi i huaj duhet të ketë një kontratë të përshtatshme për zhvillimin e punës autonome.

Viza e hyrjes për punë të pavarur lëshohet nga përfaqësia diplomatike italiane e vendlindjes së të huajit.



### **E RËNDËSISHME!**

Për të kërkuar shndërrimin e motivit të lejeqëndrimit të huaji duhet të paraqitet në Sportelin Unik për Imigrimin (Sportello Unico per l'Immigrazione) i cili do të verifikojë disponueshmërinë e kuotës për punë të pavarur, të dhënat e të cilit i dërgohen Kuesturës përkatëse nëpërmjet një procedure telematike.

### 3.1 Tregti ambulante

Të huajt që qëndrojnë rregullisht në Itali dhe që kanë dëshirë të hapin një aktivitet për tregti ambulante duhet:

◆ **Të marrin liçencën nga komuna ku kanë rezidencën.**

- (a) Për liçencën komunale është e nevojshme tërheqja e formularit përkatës pranë Zyrës së Tregtisë të Zonave publike të Komunës (*Ufficio Commercio Aree pubbliche del Comune*).
- (b) Formularit të kërkesës i duhet bashkëngjitur (në kopje të dyfishtë) dokumentacioni që vijon **dhe duhet të paraqitet në Arkivin e përgjithshëm të Komunës (Archivio generale del Comune):**
  - copia kopja e lejeqëndrimit (me afat të vlefshëm);
  - kopja e letërnjoftimit;
  - kopja e kodit fiskal (*codice fiscale*);
  - vet-çertifikimi i rezidencës;
  - vet-çertifikimi kundra mafia-s (formulari është në dispozicion pranë zyrës së tregtisë për Zonat publike) (*Ufficio Commercio Aree pubbliche*);
  - vet-çertifikimi në lidhje me zotërimin e aftësive morale të parashikuara nga neni 5, paragrafët 2 dhe 4 të D.Lgs 114/1998 (formulari është i disponueshëm pranë Zyrës tregtare të zonave publike);
  - pulla e taksës me vlerë euro **14.62** e cila duhet ngjitur mbi kërkesën.
- (c) Brenda 15 ditëve duhet sjell një pullë takse me vlerë **14.62** Euro në Zyrën Tregtare të Zonave Publike të Komunës (Uff. Comm. Aree pub. Comune).

◆ **Marrja e kodit të aktivitetit (partita I. V. A.):**

Pas dhënies së liçencës është nevojshme të merret numri i kodit të aktivitetit pranë Zyrës së Taksave (*Agenzia delle Entrate*) përkatëse për territorin ose te Regjistri i Ndërmarrjeve (*Registro delle Imprese*), së bashku me paraqitjen e kërkesës për regjistrim.

Pra duhet të paraqiten këto dokumenta:

⇒ letërnjoftimi (originali dhe fotokopja)

⇒ lejeqëndrimi (originali dhe fotokopja)

◆ **Regjistrimi në Regjistrin e Ndërmarrjeve (Registro delle Imprese):**

Regjistrimi duhet të bëhet brenda 6 muajve nga data lëshimit të licencës. Dokumentat që duhen për regjistrim dhe që duhet të paraqiten në Zyrën e Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Dhomës së Tregtisë janë (*Ufficio Registro delle Imprese della Camera di Commercio*):

- Modeli I1 (tërhiqet pranë vetë Zyrës së regjistrimit)
- Letërnjoftimi dhe fotokopja e tij
- Pulla e taksës me vlerë 14.62 Euro
- Liçenca e Komunës
- Fotokopja e lejeqëndrimit
- Derdhja e 23,00 Euro në emër të Dhomës së Tregtisë (Camera di Commercio - llogaria rrjedhëse bankare: c/c n° 218560)
- Derdhja e 94,00 Euro për të drejta vjetore në emër të Dhomës së Tregtisë (Camera di Commercio - llogaria rrjedhëse bankare: c/c n° 26064543)

Pas kryerjes së regjistrimit është e nevojshme dergimi i një certifikate regjistrimi (visura) të Regjistrimit të Ndërmarrjeve në

Zyrën e Tregtisë së Zonave (Reg delle Imprese all'Ufficio Commercio Aree Pubbliche del Comune) Publike të Komunës për shënimin e numrit dhe të datës së regjistrimit në liçencë.

**Certificata e regjistrimit (visura) është një fletë që përmbledh të dhënat e ndërmarrjes. Duhet kërkuar te Zyra e Kontrollit të Dhomës së Tregtisë (Ufficio Certificazione della Camera di Commercio).**

◆ **Regjistrimi në INPS:**

Brenda 30 ditësh nga fillimi i aktivitetit është e nevojshme paraqitja në Zyrën INPS për të bere kërkesën e regjistrimit në Administrimin e Tregtarëve. Duhet të paraqitet çertificata e regjistrimit (visura camerale) e marre parane Dhomës së Tregtisë.



**E RËNDËSISHME!**

**Për të marrë liçencën për tregëtim ambulant per prodhime ushqimore** procedura është po ajo që parashikohet për atë jo ushqimore, për më tepër është e nevojshme: **të jetë frekuentuar një kurs formimi profesional për tregëti ose në lidhje me sektorin merceologji alimentare që organizohet nga -shoqatat e kategorisë.** Vetëm më tej është e mundur të bëhet kërkesa për liçencën komunale dhe regjistrim në Dhomën e Tregtisë sipas formaliteve të përshkruara më sipër.

## PËR INFORMACIONE TË TJERA:

Zyra tregtare në zonat  
publike të Komunës  
Via Turri 8 3° piano - tel.  
Tel. 050/91 0507  
faks 050/910518

Nga e Hëna deri të Premten:  
9.30 - 11.30  
Të Martën dhe të Enjten:  
14.30 - 15.30

Zyra e këshillimit  
dhe informacinet  
050/910204

Të Hënë, Mërkurë, Enjten  
9.00 - 12.00

Arkivi i përgjithshëm i Komunës  
Lungarno Galilei, 43  
Palazzo Pretorio  
e-mail: [archivio@comune.pisa.it](mailto:archivio@comune.pisa.it)  
Tel. 050/910218-338 Faks  
050/500262

Nga e Hëna deri të Premten:  
8.30 - 12.30  
Të Martën dhe të Enjten:  
15.00 - 17.00  
Në muajt **Korrik** dhe **Gusht**  
zyra do të ketë këtë orar: nga  
e Hëna deri të Premten:  
8.30 - 12.30

CONFESERCENTI – Pisa  
via Catalani, 8  
Tel. 050/888000

Nga e Hëna deri të Enjten:  
9:00- 13:00  
dhe nga ora 15:00 - 18:00

ASCOM – Pisa  
P.zza Carrara, 10  
050/25196.7 -26199

## 3.2 Ndërmarrja

Ndërmarrja mund jetë dy llojesh: individuale dhe kolektive.

### 3.2.1 Ndërmarrja individuale

Imigrantët që kanë ndërmend të themelojnë një ndërmarrje individuale duhet t'i drejtohen Zyrës së Tregtisë ose të Aktiviteteve Prodhuese (Ufficio Commercio e Attività produttive) për të marrë informacione në lidhje me autorizimet e mundshme.

- ◆ **Është e nevojshme, më tej , regjistimi i ndërmarrjes në Regjistrin e Ndërmarrjeve (Registro delle Imprese) brenda 30 ditësh nga data e themelimit. Dokumentat që duhen për regjistrim dhe që duhet të paraqiten në Zyrën e Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Dhomës së Tregtisë janë:**
  - a) Modeli I1 (tërhiqet pranë vetë Zyrës së regjistrimit);
  - b) Letërnjoftimi dhe fotokopja e tij
  - c) Pullë takse me vlerë **14.62 Euro**
  - d) Liçenca e Komunës
  - e) Fotokopja e lejeqëndrimit
  - f) Derdhja e **23,00 Euro** në emër të Dhomës së Tregtisë (Camera di Commercio - llogaria rrjedhëse bankare: c/c n° 218560)
  - g) Derdhja e 94,00 Euro për të drejta vjetore në emër të Dhomës së Tregtisë (Camera di Commercio - llogaria rrjedhëse bankare: c/c n° 26064543)

Pas kryerjes së regjistrimit është e nevojshme dergimi i një çertifikate regjistrimi (visura) të Regjistrimit të Ndërmarrjeve në Zyrën e Tregtisë së Zonave (Reg delle Imprese all'Ufficio Commercio Aree Pubbliche del Comune) Publike të Komunës për shënimin e numrit dhe të datës së regjistrimit në liçencë.

- ◆ **Për të marrë kodin e aktivitet (Partita I. V. A.) është e nevojshme:**  
të regjistrohet ndërmarrja brenda 30 ditëve nga fillimi i aktivitetit te Zyra e Taksave përkatëse (Agenzia delle Entrate).  
(Marrim me vete lejeqëndrimin original dhe një fotokopje)
- ◆ **Regjistrimi në I. N. A. I. L.:**  
Sigurimi i detyrueshëm kundër aksidenteve në punë.  
Duhet të bëhet 5 ditë përpara se të fillohet aktiviteti. Çmimi varet nga tipi i rrezikut të aktivitetit që kryhet.
- ◆ **Duhet të përcaktohet pozicioni personal në I. N. P. S.**

#### PËR INFORMACIONE TË TJERA:

Zyra e regjistrimit të ndërmarrjeve të Dhomës së Tregtisë (Ufficio registro imprese della Camera di Commercio) P.zza Vittorio Emanuele II Hyrja nga Via Benedetto Croce Tel. 050/512353	Nga e Hëna deri të Premten: 8.30 - 12.30 Të Martën dhe të Enjten: 15.15 - 17.15
Zyra e tregtisë (Ufficio commercio) e Komunës së Pizës (Comune di Pisa) Via Turri 8 3° piano - tel. Tel. 050/910507-35 Faks 050/910518	Nga e hëna deri të enjten 9.30 - 11.30 Të Martën dhe të Enjten: 14.30 - 15.30
Zyra e këshillimit dhe e informacioneve të mërkurën, Tel. 050/910204	Në muajt <b>Korrik</b> dhe <b>Gusht</b> Zyra do të ketë orar: të hënë, mërkurën, enjten 9.00 - 12.00
CONFESERCENTI – Pisa via Catalani, 8 Tel. 050/888000	Nga e Hëna deri të Enjten: 9:00- 13:00 dhe nga ora 15:00 - 18:00
ASCOM – Pisa P.zza Carrara, 10 050/25196.7 -26199	Nga e Hëna deri të Premten: 8:30-12:30 Të Martën dhe të Enjten: 15:00-18:00



### DUHET MBAJTUR MEND

**L.I.N.P.S.** është enti më i madh i sigurimeve shoqërore italiane. Sigurohen në INPS pothuajse të gjithë punonjësit vartës të sektorit privat dhe disa të sektorit publik, ashtu si shumica e punonjësve që kryejnë aktivitete privat. Aktiviteti i tij kryesor konsiston në likuidimin e pagesave të pensioneve që janë me natyrë sigurimesh shoqërore dhe me natyrë asistence.

**L.I.N.A.I.L.**, Instituti Kombëtar i Sigurimeve kundër Aksidenteve në Punë (Istituto Nazionale Assicurazione contro gli Infortuni sul Lavoro), ndjek një shumicë objektivash: uljen e fenomenit të aksidenteve; siguron punonjësit që zhvillojnë aktivitete me rrezik; garanton rifutjen në aktivitetin punues të personave të aksidentuar, në punë.

### 3.2.2 Ndërmarrja kolektive (*S.r.l., S.n.c., S.a.s.*)

Ndërmarrja kolektive parashikon bashkëpunimin e dy ose më shumë subjekteve që marrin përsipër kolektivisht funksionin e sipërmarrjes. Pra dy ose më shumë persona mbledhin bashkërisht punë, burime financiare, kompetenca dhe ide, duke ndarë së bashku rreziqet dhe përgjegjësinë në ushtrimin e sipërmarrjes, përveç kësaj edhe të fitimeve. Për të themeluar një ndërmarrje kolektive duhet:

- ◆ **Një Statut në të cilin përcaktohen fushat dhe qëllimet e ndërmarrjes, dhe një Akt Kushtetues i shkruar në prani të**

- një noteri dhe të gjithë personave që janë të interesuar për themelimin e shoqërisë
- ◆ Duhet marrë autorizimet e nevojshme pranë Komunës ku mendohet të hapet aktiviteti
  - ◆ Kërkohet Kodi i aktivitetit (Partita I.V.A.) pranë Zyrës së Taksave (Agenzia delle Entrate) brenda 30 ditëve nga data e themelimit
  - ◆ Konfirmohet fillimi i aktivitetit pranë Zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve (Ufficio del Registro delle Imprese) brenda 30 ditëve
  - ◆ Regjistrohemi në INAIL të paktën 5 ditë përpara fillimit të aktivitetit.

### 3.3 Kooperativa

Kooperativa është një shoqëri tregtare, e parashikuar nga kodi civil dhe që karakterizohet për disa veti specifike: qëllimi i ndihmës së ndërsjellë dhe mungesa e qëllimeve spekuluese. Për tu themeluar kooperativa duhet të ketë pjesëmarrjen e të paktën 9 ortakëve. Por sipas normativës së fundit mund themelohen shoqëri kooperative me të paktën 3 ortakë kur shoqëria vë në jetë normat e të drejtës së shoqërive të cilat rregullojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar. Për të themeluar një kooperativë është e nevojshme:

- ◆ **të bëhet themelimi me akt publik përpara një noteri pasi të jetë përcaktuar një Statut që përmban normat në lidhje me funksionimin e shoqërisë. Akti kushtetues duhet të përmbajë atë çfarë parashikohet nga neni 2518 i kodit civil;**

- ◆ noteri që bën harton aktin duhet, brenda 20 ditëve, të kërkojë regjistrimin në regjistrin e ndërmarrjeve në rrethin ku do të vendoset selia shoqërore (sede sociale) dhe në të njëjtën kohë të procedojë për depozitimin e aktit kushtetues;
- ◆ të bëhet regjistrimi në Listën e shoqërive kooperativa, krijimi i të cilit ka çuar në heqjen regjistrin të prefektit;
- ◆ të kërkohej një kod aktiviteti (partita I.V.A.) pranë Zyrës së Taksave (Agenzia delle Entrate);
- ◆ të deklarohet data e fillimit të aktivitetit në Regjistrin e ndërmarrjeve (Registro delle Imprese) gjatë 30 ditëve pas datës së fillimit;
- ◆ për kooperativat që kanë ortakë punonjës ose vartës duhet të hapet pozicioni sigurues I.N.P.S. e I.N.A.I.L.

### **Për informacione dhe këshilla drejtoheni te:**

⇒ Zyrat Rajonale e Provinciale (Uffici Regionali e Provinciali)

⇒ Shoqatat e Përfaqësimit (Associazioni di Rappresentanza) pranë nënndarjeve të tyre rajonale e provinciale

<p>CONFESERCENTI – Pisa via Catalani, 8 Tel. 050/888000</p>	<p>Nga e hëna deri të enjten: 9:00- 13:00 dhe nga ora 15:00 - 18:00</p>
<p>ASCOM – Pisa P.zza Carrara, 10 050/25196.7 -26199</p>	<p>Nga e Hëna deri të Premten: 8:30-12:30 Të Martën dhe të Enjten: 15:00-18:00</p>
<p>LEGACOOOPERATIVE Pisa via S. Maria, 12 Tel. 050/25355</p>	<p>Nga e hëna deri të premten 8:30-12:30</p>

## 4. Puna shtëpiake

Punonjësi shtëpiak **është ai që vë në shërbim - me çfarëdo cilësi – punën e tij, në funksionimin e jetës familjare**, si kur bëhet fjalë për personel me një kualifikim të veçantë, ashtu edhe kur bëhet fjalë për personel që caktohet për punë të përgjithshme.

